



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 161 Prot.

Tiranë, më 13.07.2020

**PROCESVERBAL**

Sot, më datë 13.07.2020, ditën e hënë, ora 10.30, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në platformën online, përmes lidhjes Zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Këshilli u mbledh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimimi
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Znj. Nurihan Seiti
5. Z. Tartar Bazaj
6. Z. Bujar Sheshi
7. Z. Kosta Beluri
8. Z. Sandër Beci

Mungon z. Vatë Staka

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z.Gent Ibrahimimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

**Rendi i ditës:**

1. Emërimi i znj. Manjola Kajana në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

**Z. Ibrahim** hap mbledhjen dhe sqaron se Këshilli mbledhet në vijim të Vendimit nr.15 të Komisionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 10.07.2020, për të lënë në fuqi Vendimin nr.162, datë 19.06.2019 i marrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana. Z. Ibrahim thekson se znj. Kajana është një tjetër prokurore nga lista e zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për të shërbyer në SPAK, e cila ka plotësuar kushtin për kalimin e vetingut me vendim të formës së prerë, ndaj dhe mund të vijohet me emërimin e saj. Ai bën me dije se ditën e nesërme, e martë, 14 korrik 2020 do të zhvillohet ceremonia e betimit përpara Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta.

Z. Ibrahim kujton që, ky proces ka nisur që në 7 janar 2019 dhe Këshilli, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese për krijimin sa më parë të Prokurorisë së Posaçme, vendosi për fillimin e procedurave për plotësimin e organikës së SPAK-ut me 15 prokurorë. KLP nuk e pati të mundur që t'i emëronte këta prokurorë të gjithë njëherësh, duke proceduar në këtë mënyrë: emëroi fillimisht tetë prokurorë; më pas tre prej tyre dhe më vonë një prokuror tjetër. Aktualisht, SPAK-u numëron dymbëdhjetë prokurorë nga pesëmbëdhjetë që është organika fillestare, dhe emërimi i znj. Manjola Kajana e çon në trembëdhjetë numrin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Z. Ibrahim thekson se janë ende dhe dy kandidatë që presin t'i bashkohen kësaj strukture: znj. Elisabeta Imeraj, e cila nuk e ka kaluar fazën e parë të vetingut; dhe z. Anton Martini, i cili e ka kaluar këtë fazë, por kundrejt këtij vendimi është bërë ankim. Z. Ibrahim, me këtë rast, u bëri edhe një herë thirrje organeve të vetingut për të përshpejtuar afatet për verifikimin e figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale për dy prokurorët, pjesë e listës së sipërpërmendur.

**Z. Ibrahim** pyet nëse ka pyetje dhe komente.

**Nuk ka.**

**Z. Ibrahim** vijon me leximin e projektvendimit si më poshtë:

Bazuar në nenin 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48/1 dhe 163/2 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 4, nenin të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi ka verifikuar plotësimin e të gjitha kushteve dhe kriterëve të parashikuar në ligjin nr.95/2016, në referencë të Vendimit të tij nr.137, datë 16.07.2019 “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme”, si dhe të Vendimit të KPA-së nr.15, datë 10.07.2020, për lënien në fuqi të Vendimit nr.162 datë 19.06.2019 të KPK-së “Për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit znj. Manjola Kajana”, vendosi:

1. Të emërojë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme znj. Manjola Kajana për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.
2. Të njoftohen për këtë vendim Prokuroria e Posaçme, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe prokurore znj. Manjola Kajana.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**Z. Ibrahimi hedh në votim miratimin e projektaktit**

**Miratohet me 8 vota pro.**

**Z. Ibrahimi** u kujton anëtarëve që mbledhja plenare e ardhshme do të mbahet në datën 15.07.2020

**Z. Ibrahimi**

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

**Mbajtësi i procesverbalit**

(Sonila Çeliku)

**KRYETARI**

**Gent Ibrahimi**

**Shënim:**

Në këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. — Datë — 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. — datë — (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 15/07/2020  
Procesverbali të arkivohet.

**PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE**

**Frederik Sulisufi**